

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.16.02.2021*

16.02.2021
Ora 16:07

RENDI I DITËS

Projektvendimi “Për një ndryshim në vendimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 35, datë 16.12.2020 “Për miratimin e modelit dhe specifikave të vulave kod sigurie që do të përdoren në zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z.Illirjan Celibashi**
2.Stafi KQZ: **Z.Y.Merkaj, M.Koja, A.Tenolli**
- **Parti Politike:** **PD (I.Kaso), LSI (A.Kaziaj),**

Z.I.Celibashi: Mirë atëherë, fillojmë seancën publike për shqyrtimin nga Komisioneri Shtetëror të çështjeve si vijon:

1. Projektvendim “Për një ndryshim në vendimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 35, datë 16.12.2020 “Për miratimin e modelit dhe specifikimeve të vulave me kod sigurie që do të përdoren në zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021”;
2. Projektudhëzim “Për miratimin e modelit të aktmarrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe partisë politike që përfiton fondet nga buxheti i shtetit dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve”;
3. Projektvendimi “Për miratimin e modeleve të dokumenteve që do të përdoren nga grupi i numërimit dhe KZAZ-ja për pasqyrimin e rezultateve të zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021”;

*Zbardhi materialin e inçizuar
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.16.02.2021*

4. Projektvendimi “Për caktimin e vendndodhjes së disa qendrave të votimit në ndërtesa private, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021”.

Përpara se të fillojmë me shqyrtimin e secilës prej pikave të rendit të ditës ju bëj me dije që pika e tretë dhe pika e katërt e rendit të ditës nuk do të shqyrtohen në këtë seancë, do të hiqen nga ky rend dite dhe do të kalojnë për shqyrtim një seancë tjetër për konsultime të mëtejshme qoftë me përfaqësues të partive politike por edhe me të tjerë të interesuar. Kështu që do të vazhdojmë me shqyrtimin e dy pikave të rendit të ditës:

1. Projektvendim “Për një ndryshim në vendimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 35, datë 16.12.2020 “Për miratimin e modelit dhe specifikimeve të vulave me kod sigurie që do të përdoren në zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021”;

2. Projektudhëzim “Për miratimin e modelit të aktmarrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe partisë politike që përfiton fondet nga buxheti i shtetit dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve”;

Atëherë I japim fjalën sekretarit për të relatuar për pikën e parë të rendit të ditës, shkurt zoti sekretar.

Z.Y.Merkaj: Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendimin nr.35 datë 16.12.2020 ka miratuar modelin dhe specifikimin e vulave me kod sigurie që do të përdoren për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021. Numri i kodit të sigurisë së vulës duhet të shihet qartë dhe pavështirësi për të lehtësuar punën e komisionerëve gjatë kryerjes së procedurave, të dokumentacionit dhe marrjes në dorëzim nga KZAZ-ja. Shpërndarjen e tyre në vendin e numërimit të votave dhe në komisionin e qendrës së votimit. Pasqyrimi i këtij procesverbali në mbylljen e votimit në do vendoset librin e protokollit të mbledhjeve. Ndryshimi specifik

*Zbardhi materialin e inçizuar
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.16.02.2021*

teknik i ngjyrës së stampimit tek kodi i sigurisë në trupin plastik të vulës i shërben administrimit të procesit zgjedhor dhe nuk cënon asnjë nga elementët e sigurisë të përcaktuar në vendimin nr.35 të vitit 2020 të Komisionerit për miratimin e modelit dhe specifikimin të vulës me kod sigurie. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim si dhe dokumentacionin përkatës, faleminderit.

Z.I.Celibashi: Ndonjë diskutim, mendim nga përfaqësuesit e partive? Nuk kemi. Mirë atëherë, e miratoj projektaktin sipas draftit të paraqitur dhe të propozuar.

Vendimi nr.82

*Zbardhi materialin e inçizuar
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.16.02.2021*

16.02.2021
Ora 16:10

RENDI I DITËS

Projektudhëzimi “Për miratimin e modelit të aktmarrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe partisë politike që përfiton fondet nga buxheti i shtetit dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ”.

PJESËMARRJA :

- KQZ
 - 1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve Z.Ilirjan Celibashi
 - 2.Stafi KQZ: Z.Y.Merkaj, A.Tenolli, M.Kaja
- Parti Politike: PD (I.Kaso), LSI (A.Kaziaj)

Z.I.Celibashi: Vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës.

Z.Y.Merkaj: Neni 19 i Kodit Zgjedhor ka parashikuar kompetencën e Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve për të lidhur në emer te Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve marrëveshje të kontratave me të tretët për tu kujdesur për zbatimin e këtij ligji në mënyrë të drejtë e pikë të saktë dhe uniforme nga të gjitha institucionet, subjektet dhe personat e ngarkuar me detyra dhe detyrime sipas ligjit për të monitoruar ndërmjet administratës së KQZ-së apo subjekteve të kontraktuara, subjektet zgjedhore. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve referuar nenit 88 të Kodit Zgjedhor përcakton modalitetet e aktmarrëveshjes së bashkëpunimit i cili do të shkruhet nëpërmjet Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe partisë politike që përfiton fondin nga buxheti i shtetit dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Qëllimi i kësaj aktmarrëveshje është angazhimi i palëve për përdorimin e fondeve të përfituara nga

*Zbardhi materialin e inçizuar
Silvi Sino*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.16.02.2021*

buxheti i shtetit dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve që do ti jepet partisë politike përfituese në zbatim të të gjitha kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara në Kodin Zgjedhor. Në këtë aktmarrëveshje përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e secilës palë për tu angazhuar të shqyrtojmë në mënyrë të ndërsjelltë kërkesat dhe propozimet e dyanëshme dhe të mbajë kontakte të rregullta nëpërmjet strukturave përgjegjëse. Për këtë qëllim kemi përgatitur aktmarrëveshjen e cila është paraqitur sot për shqyrtim dhe miratim nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.

Z.I.Celibashi: Faleminderit! Nga përfaqësuesit e partive politike kemi ndonjë koment, ndonjë propozim?

Z.I.Kaso: Jemi dakord të nderuar është një aktmarrëveshje e cila respekton jo vetëm frymën e ligjit por dhe dispozitat konkrete për sa i përket çështjes së financimit, angazhimit të subjekteve për ta bërë transparent pjesën e financimit. Në përmbajtje referohem ekzaktësisht disponimet dhe detyrimet ligjore, kështu që shprehem dakord për aktin e propozuar i cili ka të bashkëngjitur projekt marrëveshjen.

Z.I.Celibashi: Faleminderit, nuk kemi ndërhyrje tjetër. Meqenëse jemi dakord me draftin e paraqitur vendos miratimin e këtij projektudhëzimi sikurse bashkëlidhur edhe draftin e aktmarrëveshjes së bashkëpunimit që do të lidhen ndërmjet Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe partisë politike që do të përfitojë fonde nga buxheti i shtetit dhe KQZ-së. Me këtë pikë mbyllet dhe seanca për ditën e sotme. Faleminderit dhe punë të mbarë!

Udhëzimi nr.3

*Zbardhi materialin e inçizuar
Silvi Sino*

